

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

---

### Rehatia / *et-Tuma'nineh* / الطَّمَانِينَةُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"يَا أَيُّهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ"

"O shpirt i rehatuar ..." (el-Fexhr, )

*Tuma'nineh* është një rehati që mbështetet në një siguri të njëmendtë<sup>1</sup>, e cila, për sa i përket nivelit të bindjes, është e ngjashme me të parët e syrit. Ka dy dallime mes shkallës së rehatisë (*tuma'nineh*) dhe asaj të qetësisë (*sekineh*).

E para: *Sekineh* është një shtysë e herëpashershme që shkakton zvogëlimin e intensitetit të druajtjes<sup>2</sup>; *tuma'nineh* është rehati që vjen nga siguria në oazën e intimitetit prehës (*uns*).<sup>3</sup>

E dyta: *Sekineh* është një përshkrim që thjesht mund ta kesh nganjëherë, kurse *tuma'nineh* nuk ndahet asnjëherë nga poseduesi i saj.

Kjo ka tri nivele.

Niveli i parë është rehatia e zemrës në kujtimin e Allahut. Kjo është rehatia të cilën:

- I frikësuar gjen në shpresë
- I acaruar gjen në nënshtrimin ndaj caktimit të Allahut

---

<sup>1</sup> Jo një siguri e rrejshme, që vjen nga moskujdesi, nga iluzioni, dhe duke i bërë qejfin vetes.

<sup>2</sup> Druajtja që vjen nga reflektimi për cilësitë e madhështisë dhe të fuqisë së Allahut.

<sup>3</sup> *Unsi* që vjen në gjendjen e bashkimit me të Vërtetin duke reflektuar për cilësitë e Tija të mëshirës e të hijeshisë dhe për qenësinë (*dhaat*) e Tij.

- I dëmtuari gjen në pritje të shpërblimit

Niveli i dytë është rehatia e shpirtit:

- Në zbulimin<sup>4</sup> gjatë udhëtimit
- Në premtimin gjatë dëshirimit<sup>5</sup>
- Në bashkim (shoqërim me Allahun) gjatë shpërqendrimit (*tefrikah*)<sup>6</sup>

Niveli i tretë:

- Rehatia në butësinë (hyjnore) gjatë të parit e pranisë (hyjnore)<sup>7</sup>
- Rehatia në shkallën e qëndresës (*bekaa*) gjatë gjendjes së bashkimit/shoqërimit<sup>8</sup> (me Allahun)
- Rehatia në dritën e para-përjetësisë në shkallë/stacion.<sup>9</sup>

---

<sup>4</sup> Zbulimet tregojnë detaje të shtegut dhe të vendmbërritjes, duke i dhënë kështu garanci udhëtarit (për realizimin e premtimit).

<sup>5</sup> Ndërsa dëshiron kënaqësinë e Tij, ti gjen ngushëllim në premtimin e Tij për bamirësit.

<sup>6</sup> Preokupimi yt në këtë botë shkakton *tefrikah* (shpërqendrim, devijim), kështu që bashkimi/shoqërimi yt me Allahun gjatë devocioneve (madje edhe gjatë angazhimeve tua) do t'i ofrojë shpirtit tënd rehati dhe vetëpërmbajtje.

<sup>7</sup> Ndërsa zemra jote sheh/ndien hyjnoren, vetëdijesimi për butësinë e Tij do ta mbajë atë të qetë.

<sup>8</sup> *Bekaa* (të qëndruarit me Allahun, nëpërmjet Allahut, për Allahun) jote do të vijë nga bashkimi/shoqërimi yt me Të dhe zemra jote do të gjejë stabilitet në këtë shkallë të lartë.

<sup>9</sup> Me vetëdijesimin për njësinë e origjinës, drita e para-përjetësisë heq çdo errësi dhe vendos gjërat në perspektivën e duhur.